

1.Mesa jam informuar ju jeni këtu për herë të parë në Tiranë në një konferencë për disinformimin dhe fake news, çfarë mund të thoni për ditën tuaj të dytë duke punuar me gazetarë dhe studentë të gazetarisë nga Shqipëria por edhe nga Ballkani?

Është hera ime e parë në Shqipëri por nuk është hera ime e parë në vendet e Ballkanit, arsyeja pse mua më pëlqen të vij në vendet e Ballkanit është sepse shumë zhvillim po ndodh këtu. Është risi në ballkan bashkëpunimi që po ndodh me mediat ose organizatat mediatike përqark Ballkanit. Kjo risi nuk është se ndodh në vende të tjera, nuk është se ndodh mesa di as edhe në Europën Perëndimore. Gjithashtu edhe idetë këtu janë të lidhura me teknologjikë si platformat e fundit të verifikimit të fakteve mendoj se krijimi i tyre është një ide inovative dhe kjo është një mësim për gazetarinë e Europës Perëndimore.

2.Nga 2014 deri 2016 ju jeni marrë intensivisht me gazetari investigative, ju ishin gazetari kryesor në një ekip prej shumë gazetarët të cilët zbuluan shumë skandale, një ndër to edhe Panama Papers, si i ranë në dorë dokumentet e kompanive offshore organizatës ICIJ (*International Consortium of Investigative Journalists*) (*Konsorciumi Ndërkombëtar i Gazetarëve Investigues*) dhe cili ishte roli juaj në këtë investigim që ka fituar edhe çmimin Pulitzer?

Detyra ime ishte të merrja të dhënat, unë isha pikë e kontaktit me burimin. Gjithashtu duhet të procesoja dhe sistemoja këto të dhëna por edhe të ngrija platformën me ekipin tim që do të bënte përgatitjen e këtyre të dhënave. T'i bënte dokumentet me informacione në një format të kuptueshëm për t'u lexuar nga gazetarët në të gjithë botën që po punonin me këtë investigim. Të dhënat erdhën tek organizata ICIJ që në fillim pasi ne kemi bashkëpunime globale që përfshin gazetarë kudo në botë. Ekipi i gazetës në Gjermani që kishte të dhënat foli me ne duke e ditur që ne kishim ekipin por edhe inxhinier softuerik si puna ime por edhe ne kishim mundësitë për të bërë diçka.

3.Shqipëria ishte e përfshirë në këtë skandal, disa kompani nga Shqipëria kishin lidhur kontrata përmes agjencisë Mossack Fonseca. Në opinionin tuaj si gazetar investigativ, a ishte e mundur që kjo histori të zbulohet nga gazetarët shqiptarë nëse do të kishin lidhjet e duhura dhe burimet e duhura? apo duhej një ekip special me gazetarë dhe inxhinierë?

Problemi këtu është aksesimi në informacion. T'i mund të kesh të gjitha aftësitë më të mira, t'i mund të jesh gazetari më i mirë në botë por nëse nuk do ishte fati në mes, dua të them që ishte edhe një çështje fati pasi pati një rrjedhje informacioni nga Mossack Fonseca (Monsak Fonseca), kjo histori nuk do të dilte kurrë. Ky është një problem i

patejdukshmërisë në kompanitë offshore, ka një serë juridiksionesh si në Panama, Ishujt e Virgjër Britanikë, Shtetet e Bashkuara që garantojnë patejdukshmërinë në përfshirjen e kompanive. Një politikan në Shqipëri mund të përfshijë një kompani në Delaware ose në Panama ose , Ishujt e Virgjër Britanikë dhe askush nuk do e marr vesh që kjo ka ndodhur. Ata mund të hapin llogari bankare në ishujt e Virgjër Britanikë, Dubai dhe askush s'do e mësojë që ata e bënë këtë sepse ekziston një perde në këtë fushë. Pavarësisht sa i zoti mund të jesh si gazetar, për shkak të mënyrës se si ky sistem është disenjuar dhe për shkak se sa i fshehtë dhe jo transparentë është t'i nuk do mundesh të gjesh informacionin, vetëm nëse ka një rrjedhje informacioni. Po ne nuk mund të varim shpresat në këto rrjedhje informacioni për demokracinë dhe gazetarinë. E vetmja mënyrë për të mësuar diçka është përmes bashkëpunimit me gazetarë të tjerë dhe ekipe të tjera. I vetëm nuk mund t'ia dalësh dot kurrë pa punën në ekip.

4.Në prill 2017 ekipi i drejtuar nga ju fitoi çmimin Pulitzer, çmimin më të lartë një gazetarë mund të marrë, çfarë do të thotë kjo për ju?

Isha i lumtur por ishte totalisht e papritur, unë nuk e prisja një gjë të tillë për punën që bëmë. Personat e përfshirë në këtë skandal dhe politikanët e quajten Fake News (lajm të pavërtetë) ose si një sulm ndaj Panamasë por nuk ishte kështu. Ne po raportojmë një histori të një niveli global, ne nuk ishim kundërvënë ndaj askujt, mbase ndaj sistemit që lejon këtë korrupsion dhe krim të lulëzojë. Ne morën të dhënat, investiguam, zbuluam se shumë persona atje ishin përfshirë në aktivitet kriminal, shumë prej tyre ishin politikanë, të tjerë biznesmenë me lidhje politike dhe kjo histori duhej që të tregohet. Por në të njëjtën kohë është e vështirë për mua të flas çmimin pasi nuk ka mbaruar, ne kemi një rrugë të gjatë përpara. Mendoj se ajo që ndodhi në Maltë me vrasjen e mamasë sime dhe politikanët e vënë nën hetim pasi u zbuluan si të përfshirë në skandal për fshehjen e parave dhe ryshfeteve. Përsëri këta persona janë në pushtet, shefi i stafit të kryeministrit, një ministër dhe vetë kryeministri i Maltës i mbron ata. Fakti që kjo gjë po ndodh në Bashkimin Europian tregon se ka një rrugë të gjatë përpara, çmimi mendohet se është një hap përgjatë kësaj rruge që na ndihmon ne. Një farë njohje e asaj çfarë po bëjmë.

5.Në tetor 2017 një tragjedi për familjen tuaj, nëna juaj u vra me një bombë në makinë pranë shtëpisë në Maltë. Ajo ishte një gazetare e njohur që ka mbuluar korrupsionin në nivelet e larta të qeverisë dhe krimin e organizuar. Si e ndryshoi karrierën tuaj në gazetari kjo ngjarje?

E ndryshoi totalisht, unë duhet të linja punën time tek organizata *ICIJ (International Consortium of Investigative Journalists) (Konsorciumi Ndërkombëtar i Gazetarëve Investigues)*, unë nuk mund të rikthehem dot më në jetën time përpara se mamaja ime të vritej. Por tani nuk ka as drejtësi, e vetmja gjë që mund të na çojë sa më afër arritjes

së drejtësisë, edhe për vrasjen e nënës sime por edhe për investigimin është të mbajmë në presion qeverinë Malteze.

6.Çfarë është duke bërë shteti i Maltës për të zbuluar organizatorin e këtij sulmi?

Asgjë, asgjë, absolutisht asgjë, Qeveria po përpiqet të mbulojë atë çfarë ndodhi me mamanë time, madje ata kanë mohuar se mamaja ishte është vrarë.

7.Po tre personat e arrestuar si autorë, a do të dënohen ata dhe të kalojnë kohën në burg?

Ashtu shpresoj, por ka një rrezik të madh që çështja e ngritur ndaj tyre mund të bjerë dhe ata mund të mos shkojnë fare në burg. Ka një rrezik të madh që ata mund të lirohen.

8.A ishit ndonjëherë i frikësuar si gazetar investigativ përpara vrasjes së nënës suaj, po pas tragjedisë në familjen tuaj?

Sigurisht që kam qenë i frikësuar, mund të shihja që situata në Maltë ishte e vështirë, gjërat po bëheshin të rrezikshme dhe unë mund ta shihja këtë por ne duhet të bëjmë punën tonë. Mamaja ime duhej të bënte punën e saj, unë duhej të beja punën time, ne duhej të dokumentonim atë që po ndodhte. Kjo ishte diçka që mamaja ime e thoshte, ne duhet të dokumentojmë atë që po ndodh.

9.Çfarë ju inspiroi ju të bëheni një gazetar investigativ?

Mamaja ime, duke u rritur me punën që mamaja ime bëri. Duke parë situatën në Maltë, duke parë sesa demokraci të varfër kishim dhe rritja e niveleve të korrupsionit mendoj se kjo ishte ajo që më bëri të vendosur për të bërë diçka. Unë e dua vendin tim, qeveria atje shpërndan një të pavërtetë se njerëzit që luftojnë korrupsionin nuk e duan vendin e tyre por ne e bëjmë këtë sepse e duam vendin tonë dhe duam që ai vend të jetë më i mirë.

10.Cili është mesazhi juaj për mua dhe kolegët e mi gazetarë, si mund të jemi të fortë, të patrembur dhe si mund të bëjmë gazetari cilësore investigative?

Kurrë mos u dorëzoni! Duhet të jeni këmbëngulës dhe veçanërisht kurrë mos u dorëzoni kur njerëzit janë duke u ngacmuar ju ose ju thonë të ndaloni atë që po bëni ose ajo që ju po bëni është e kotë.